

VENDIM
Nr. 480, datë 16.7.2014

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 172, DATË 26.3.2014, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË
DREJTAT E NJERIUT, DATË 15.1.2013, PËR ÇËSHTJEN NR. 49109/06, “DELVINA KUNDËR
SHQIPËRISË””**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe nenit 10, të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 172, datë 26.3.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Në të gjithë përmbajtjen e vendimit, numri i aplikimit të çështjes nga “nr. 49109/06”, bëhet “nr. 49106/06”.

2. Pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 15.1.2013, për çështjen nr. 49106/06, “Delvina kundër Shqipërisë”, në shumën 2 025 900 (dy milionë e njëzet e pesë mijë e nëntëqind) euro, si dhe pagesën e tatimit mbi të ardhurat për dëmshpërblimin.”.

3. Në fund të pikës 4 shtohet fjalia si më poshtë vijon:

“Në rast mospagimi brenda këtij afati, mbi shumën e mësipërme paguhen interesa të thjeshta të barabarta me kursin marzhinal të huas së Bankës Qendrore Evropiane, gjatë periudhës së mospagimit, plus tre për qind.”.

4. Pika 5 ndryshohet si më poshtë vijon:

“5. Efekti financiar për zbatimin e këtij vendimi të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama